

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"SSK Concept" SH.P.K.

NENI 1

Sot me date: 08 / 03 /2022, themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "SSK Concept" sh.p.k., mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjin nr. 9121, date 28.7.2003,

"Per Mbrojtjen e Konkurrences", Kodin Civil dhe Kodin e Punes me dy ortake themelues si vijon:

Sokol Allaraj, shtetas Shqiptar lindur Kukes dhe banues ne Rr. e Elbasanit, Tirane, mbajtes I kartes se identitetit me nr. **ID H10101318F** dhe **Safet Myftari**, shtetas Shqiptar lindur dhe banues ne Topojan, Kukes mbajtes i kartes se identitetit me nr. 032671793 dhe **ID G90401089W**.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Eksod 99, Lagjia 5, Pallati 10, Kati I-re, afer Gjykates Kukes.**

Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Kuksit. Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjetër.

KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

NË FUSHAT E STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT NË NDËRTIM: projektim urbanist, projektues arkitekt, projektues konstruktor, projektues instalator, projektues vepra hidraulike, projektues rruge – hekurudha, projektim ura dhe vepra arti, projektues gjeodet, studim gjeologo-inxhinierik – hidrogjeologjik, projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektues të sinjalizimit rrugor, studime të sizmologjisë inxhinierike.

NE FUSHEN PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI (Punime gërmimi në tokë, Ndërtime civile dhe industriale, Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, Punime nëntokësore, ura e vepra arti, Diga dhe tunele hidroteknike, Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje, Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë, Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime, Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, Punime të inxhinierisë së mjedisit).

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI (Punime për prishjen e ndërtimeve, Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre, Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues), Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese, Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, Sinjalistika rrugore jondriçuese, Barriera dhe mbrojtje rrugore, Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri, Punime strukturore speciale, Shtresa dhe mbistruktura speciale, Punime mbi shina dhe traversa, Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit, Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj, Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore, Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij, Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, Punime topogjeodezike, Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë, Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë).

NË FUSHËN E VLERËSIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME: Për ndërtesat dhe tokë truall, Për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë, livadh dhe tokë të pafrytshme.

NE FUSHA TE NDRYSHME TE EKSPERTIMIT: Auditim i Brendshem Financiar ne Sektorin Publik, ekspert fiskal etj.

NE FUSHEN E MENAXHIMIT TE PRONAVE: Menaxhim pronash dhe ndertesash, toke bujqesore, pyjore, ndertesa banimi dhe biznese. Ndermjetesime per dhenie dhe marrje me qera ambientesh private dhe shit-blerje, administrim dhe mirmbajtje, agjensi imobiliare.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

1. Kapitali i shoqërisë ka vlerën 100 lekë i cili përbëhet nga 2(dy) kuota.

2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi te kapitalit nëpërmjet shtimit te kuotave te reja, ortakët kanë te drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund te zvogelohet nen kufirin minimal qe lejon ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KONTRIBUTET

NENI 6

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga dy ortakë, **Sokol ALLARAJ** i cili zoteron 1 (nje) kuote ose 50% te vleres se kapitalit dhe **Safet MYFTARI** i cili zoteron 1(nje) kuote ose 50% të vlerës së kapitalit.

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 7

1. Ortakët kanë të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi ngabashkëshorti ose nje person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqesimi i nje ortaku nga nje ortak tjeteter apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkrese, ose nepermjet postes elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e meposhtme dhe eshte pergjegjese per to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;
 - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar;
 - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
- g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
- h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.

10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se pergjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.


14. Asambleja pergjithshme vendos me shumice të zakonshme për cështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave dhe vendimet merren me shumicë të votave të ortakëve pjesemarres.

15. Asambleja e pergjithshme vendos me shumice të kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme behet vetem nese ortakët që zoterojne me shume se 70% e kuotave jane të pranishem, votojne me shkrese apo mjete elektronike. Ne kete rast vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesemarres.

16. Nëse asambleja e pergjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur në kete pikë, të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

ADMINISTRIMI

NENI 8



1. Shoqëria administrohet nga nje ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se pergjithshme sipas parashikimit ne kete statut.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

NENI 9


1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE

NENI 10

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare do të jetë **Z. Safet MYFTARI**, shtetas shqiptar, lindur Topojan, KUKES banues Topojan, Kukes; dhe numer personal ID: **G90401089W**.

EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR



NENI 11

1. Në rast nevojë si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.

2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

E DREJTA E VOTES

NENI 12

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

E DREJTA PER TE KALUAR REZOLUTE

NENI 13

Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolute pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolute në mbledhjen e asamblese së përgjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortakët personalisht dhe ta votojnë ato në mënyrë të unifikuar.

ZHVILLIMI I SHOQERISE

NENI 14

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë ligjore, objektin, mund të zmadhojë apo të zvogelojë kapitalin themeltar, mund të pranojë ose të largojë ortakë.

MARRREDHENIET E PUNES NE SHOQERI

NENI 15

Shoqëria do të përpilojë dokumentet përkatëse për punësimin e personave të tretë duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës.

VULA E SHOQERISE

NENI 16

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme me tekstin përreth saj.

FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK

NENI 17

Shoqëria do të rregullojë veprimtarinë e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi të nënshkruhet nga ortakët themelues do të fitojë personalitet juridik në ditën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

BILANCI DHE FITIMI

NENI 18

18.1. Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.

18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

FUNKSIONIMI I SHOQERISE

NENI 19

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise pervec ketij Akti Themelimi jane te percaktuara ne Statutin e Shoqerise.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 20

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridike e fizike vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukes sipas legjislacionit ne fuqi.

DISPOZITA TE TJERA

NENI 21

Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopje, duke patur secila kopje fuqi te plote ligjore.

THEMELUESIT E SHOQERISE " SSK Concept" shpk

ORTAKU

SOKOL ALLARAJ



ORTAKU

SAFET MYFTARI

